

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 98 paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, neni 14 paragrafi (4) i Rregullores për teknika të reja reklamimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.56/15), pika 5 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1367/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/9 datë 10.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, për shkak të shkeljes së nenit 98 paragrafit (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 14 paragrafi (4) të Rregullores për teknika të reja reklamimi (RTRR) të mënyrës që në kuadër të shërbimit programor televiziv, transmetuar më 4 mars 2025, në edicionin premierë të emisionit "Thirre 21-shin (Povikaj go 21)", u transmetuan reklama pop-ap/ me ekran të ndarë mes të cilave nuk kaloi periudha e parashikuar prej së paku 15 minutash.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1367/1 datë 27.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RTRR.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe data e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte tjera të miratuara nga Agjencia.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndaj botuesi të medias (transmetuesit) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer shkelje ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe akte tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 98, paragrafi (2) të LSHMAAV, Rregullat për teknikat e reja të reklamimit përcaktohen nga Agjencia, dhe sipas nenit 14, paragrafi 4 nga RTRR, ndërmjet paraqitjes së dy reklamave në ekran të ndarë duhet të kalojë një periudhë prej së paku 15 minutash.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 27.03.2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, transmetuar më 4 mars 2025, në nivel shtetëror, ku është konstatuar shkelje e nenit 98 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe nenit 14 paragrafi (4) të RTRR.

Gjegjësisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se më 4 mars 2025, SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, në edicionin premierë të emisionit aktual informativ " Thirre 21-shin (Povigaj go 21) " në kundërshtim me nenin 14, paragrafi (4) të Rregullores janë transmetuar reklama pop-ap/ në ekran të ndarë ku nuk respektohet periudha e caktuar prej së paku 15 minutash.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1367/1, datë 27.03.2025 që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, më 28.03.2025, dërgoi Shkresë ark.nr.10-1367/2 datë 28.03.2025, me të cilën i dërgoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr. 10-1367/1, datë 27.03.2025, që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RTRR. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 28.03.2025. Në afatin e parashikuar SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RTRR. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 10.04.2025, e shqyrtoi Raportin me shkrim në fjalë dhe konstatoi që SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 98 paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, neni 14 paragrafi (4) i RTRR, pika 5 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1367/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/9 datë 10.04.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe RTRR, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 10.04.2025 miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmërohet SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup dhe urdhërohet që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizon punën e saj me dispozitat e LSHMAAV dhe RTRR. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në bazë të nenit 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës administrative. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në aafat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark. nr.10-1367/1 datë 27.03.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.